

ILIRJANA NANO

**ASPEKTE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË
NË PASHALLËKUN E JANINËS**

**Marrja e pushtetit dhe konsolidimi
i tij nga ana e Ali Pashës**

Pashallëku i Janinës njohu një jetë 35 vjeçare nën sundimin e Ali Pashës. Tepelenasi u vu në krye të sanxhakat të Janinës në fund të vitit 1787, duke shfrytëzuar mungesën e mytesarifit të këtij sanxhaku dhe duke patur përkrahjen edhe të shtresave të pasura të Janinës. Përqëndrimi i qeverisjes së sanxhakat të Janinës dhe atij të Tërhallës në një dorë të vetme (pra të Ali Pashës), krijoi bërthamën e Pashallëkut të Janinës.¹ Sundimi i tij zgjati deri në vitin 1822. Porta e Lartë, e gjendur në luftë me Rusinë dhe me Austrinë në fillim të vitit 1788, detyrohet ta miratojë mbas dy vitesh, shtrirjen e pushtetit dhe autoritetit të Ali Pashës dhe vetë atë si zot të Janinës me një ferman të veçantë.²

Në vitet kur Aliu mori Pashallëkun, territoret ballkanase në tërësi dhe ato greke e shqiptare në veçanti qenë të dominuara nga anarkia, brigandizmi, çetat e komitëve dhe pushteti i hajdutëve të famshëm. Është kjo arsyeja që, gjysma e dytë e shekullit të XVIII dhe fillimi i shekullit të XIX, konsiderohen periudha që, këto anë dominoheshin jo më nga ligji, por nga antiligji dhe anarkia. Aq i vërtetë ishte ky realitet, sa historiografia ballkanase e karakterizon këtë hark kohor si “periudhë të sundimit të kleftokratisë, jo të turkokratisë”. – Këto anë ishin nën pushtetin e hajdutëve dhe jo nën pushtetin osman.³

Pushteti i Pashait njohu një rritje të madhe si në pikëpamje gjeografike, territoriale ashtu edhe numerike të popullsisë. Politikisht,

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë: “Toena”, 2002, f.633-638.

² Frédéric Guillaume Vaudoncourt, *Memories of the Ionian Islands, Albania*, London: 1815, f.233-237.

³ Apostolos Vacalopoulos, *The history of Macedonia*, Thesaloniki: 1974, f. 330-337.

ushtarakisht dhe ekonomikisht ai mori dimensionet e një fuqie të vërtetë imponuese në Ballkan. Ndërkohë, edhe pse administrativisht ishte dhe mbeti pjesë e Perandorisë Osmane, Pashallëku i Janinës në vitin 1808, qe kthyer pothuaj “de facto” në një formacion shtetëror të njohur ndërkombëtarisht.

Përmes masave dhe veprimeve aktive, radikale dhe kurajoze në fushën e organizimit shtetëror, përdorimit të masave policore dhe aplikimit të ligjeve efektive, ai arriti të vendosë rendin, qetësinë dhe sigurinë publike në tërë horizontet gjeografike të pashallëkut të tij. Kusaria, banditizmi, anarkia, evazoni fiskal, nën efektin e ligjeve të ashpra dhe respektimit kërcënues të tyre, i hapën rrugë rendit, qetësisë dhe progresit drejt standardeve të një shoqërie të civilizuar.

Hajduti i djeshëm Ali pasha, me marrjen e pushtetit, u kthye në ndjekës dhe persekutor i hajdutëve.

Sipas gazetarit danez, Olaf Bronstad:

*“Në fund të fundit, mua më duket se një grabitës i privilegjuar është më mirë se një lukuni tiranësh të vegjël, jo vetëm për udhëtarët, por edhe për banorët e kujtdo vendi qoftë; së paku pazaret mund të bëhen vetëm me një, por që nuk ka ujdi me morinë e grabitësve të vegjël; pasi despotizmi, ndonëse përbindësh dhe shfarosës për nga natyra, edhe prodhon ndonjë gjë të mirë, kurse anarkia, kjo murtagjë e rendit shoqëror, nuk sjell kurrë ndonjë përfitim, i çfarëdo lloji qoftë”.*⁴

Në fushën e së drejtës Ali Pasha, nuk përmbysi, nuk rrëzoi dhe as shfuqizoi regjimin juridik të së drejtës, që ishte në fuqi dhe që vepronte mbi popullsinë maxhoritare myslimane, por as cenoi privilegjet ligjore të të krishterëve që ishin pjesë e konsiderueshme e popullsisë në Pashallëkun e Janinës. Përkundrazi, siç dëshmohet nga veprimet që ai ndërmoi, Ali Pasha tregoi një interesim të jashtëzakonshëm për të kufizuar dhe luftuar korrupsionin nga ana e gjykatësve osmanë. Ai u mor vetë, personalisht me çështjet e vendosjes së drejtësisë, duke pranuar edhe aktet e strehimit politik (dhe nënshkruar ligjin e azilit) dhe duke gjykuar me cilësinë e Kreut të Drejtësisë (Kryegjyqtar), shumë çështje të karakterit penal, civil dhe administrativ që ishin gjykuar më parë nga gjykatat e shkallëve më të ulta.⁵

⁴ Peter O. Bronsted, *Intervista me Ali Pashë Tepelenën, 1817*, Tiranë: Shtëpia botuese “Horizont”, 2003, f. 12.

⁵ Dhim. Zotou, *I dhiqeosini eis to kratos tou Ali Pasha*, Athinë: 1938, f. 45.

Mendja, gjenialiteti, vullneti, politika dhe masat që ai ndërmoi, përmbysën në mënyrë radikale korrupsionin e administratës, zgjidhën shumë probleme që deri atëherë kishin për instrument rryshfetin. Ali Pasha ngriti struktura efektive dhe ofroi në pozicione të larta të shtetit të tij njerëzit më të ndritur, të kulturuar, të arsimuar në Europë dhe të besuar.

* * *

Sistemet e të drejtës që vepronin në Pashallëkun e Janinës

Duke parë me kujdes tërë sistemin e ligjeve dhe të normave që u zbatuan në territoret dhe mbi popullsinë e Pashallëkut të Janinës, duhet thënë që në fillim, se prej gati katër shekujsh, pothuaj të gjithë kufijtë ballkanikë, si territore që përfshiheshin nën sundimin e gjysmë hënës osmane kontrolloheshin dhe administroheshin nga ato ligje që normonin jetën dhe veprimtarinë e vetë kësaj Perandorie. Pra, sistemi i drejtësisë në Pashallëkun e Janinës mbeti pjesë dhe pasqyrë e **sistemit osman të drejtësisë**. Kjo mund të thuhet si për normat e organizimit dhe funksionimit të strukturave dhe administratës shtetërore, aq edhe në këndvështrimin e legjislacionit që aplikonin dhe zbatonin këto institucione.

Në fushën e së Drejtës Penale vepronte Sheriati, ligj që shtrihej në tërë kufijtë e Perandorisë. Në të njëjtën mënyrë vepronte ai edhe në territoret e Pashallëkut. Brenda kësaj të drejte përfshiheshin edhe normat që rregullonin marrëdhëniet civile, familjare apo dhe morale mes kristianëve dhe myslimanëve, të drejtat, detyrimet dhe barrierat në çështjet martesore apo jashtë martesore, ku parashikoheshin edhe ndëshkime të rënda e pse jo satanike (siç mund të ishin sanksionet për marrëdhëniet jashtëmartesore mes një kristiani dhe një vajze myslimane....).⁶

Në fushën e të drejtës administrative dhe financiare, të sistemit fiskal, të tatim taksave, në fushën e doganave etj.; vepronin ato norma të cilat qenë unike (me ndyshime të vogla) për gjithë Perandorinë.

Në Pashallëkun e Janinës, për të gjitha çështjet që lidheshin me pasuritë e paluajtshme, me shitblerjet e pasurive, qeratë, posedimin e pronës, vlenin formulimet ligjore të normave të të drejtës osmane.

⁶ *Po aty*, f. 95-99.

Konfliktet tregtare për shuma të mëdha (të rëndësishme) gjykoheshin nga gjyqtarë, vendimet e të cilëve vërtetoheshin (ratifikoheshin) nga institucionet vendore të pushtetit. Këto vendime mbështeteshin në formulimet ligjore të shkruara të të drejtës tregtare dhe në bazë të zakoneve, siç ndodhte edhe në pjesën tjetër të Perandorisë, para vendosjes në mënyrë të unifikuar në të gjithë Perandorinë, të të drejtës Tregtare Otomane.

Në aspektin e detyrimeve financiare, Ali Pasha kishte një kuotë të caktuar vjetore ndaj Portës, shumë në të holla të cilën ishte i detyruar ta paguante dhe që e siguronte nga vjelja e llojeve të ndryshme të taksave të përcaktuara me ligj.⁷

Por, veç të drejtës osmane, në radhën e sistemeve ligjore të cilat aplikoheshin në terrene të caktuara brenda Pashallëkut të Janinës, vepronin edhe norma ligjore të trashëguara nga e drejta bizantine, (apo siç thirrej “Kodi agrar perandorak-bizantin), e cila kishte vepruar në territoret dhe mbi popujt ballkanikë për gati nëntë shekuj.

E drejta Bizantine, thirrur ndryshe “e drejta kristiane apo kishtarë” (Harmenopulos)⁸ kishte fuqi dhe shtrinte efektet e saj për popullsinë e krishterë të shtetit të Ali Pashës, me të njëjtat efekte sikurse ajo vepronte në Peshkopatat dhe Kryepeshkopatat jashtë këtij shteti. Kjo e drejtë vihej në zbatim përmes strukturave të saj, siç ishin Gjykatat Kishtarë.

Me fjalë të tjera, në administrimin e drejtësisë, Kisha bazohej mbi kanunet dhe ligjin bizantin. Këto privilegje politike Kishës ortodokse i ishin dhënë në formë koncensionit nga ana e Sulltanit si për administrimin

⁷ *Arhio Ali Pasha*, Vol. IV, Instituto Neolinikon Spudon, Genadio Bibliothikis, Athinë: 2009, f.105.

⁸ Konstantin Harmenopoulos (apo Armenopoulos) është jurist grek i periudhës së vonë bizantine. Në vitet 1344-1345 ai ka shkruar “Procheiros Nomos” apo siç njihet Hexabiblos. Në fakt puna e tij nuk është një punë e mirëfilltë krijuese, por ai ka përmbledhur dhe ka sistemuar në mënyrë tematike korpusin ligjor të gjetur prej tij, për t’i shërbyer më mirë gjyqtarëve. Puna e tij e admirueshme i shërbeu popullsisë të Perandorisë së Bizantit edhe pas rënies së tij, gjatë pushtimit otoman dhe madje deri në miratimin e Kodit të Ri Civil në shtetin modern grek në 1946. Hexabiblos është një përmbledhje normash juridike që rregulloi jetën e të krishterëve ortodoksë, sikundër Sheriati atë të popullsisë myslimane dhe e drejta kanonike për katolikët.

e drejtësisë edhe për organizimin e arsimit.⁹ Nisur nga kjo premise, edhe pashai i Janinës, vazhdoi të ruante privilegjet ligjore të të krishterëve dhe të Kishës Ortodokse.

Detyrimi për paraqitje përpara këtyre gjykatave ishte imponues, në të kundërt subjekti që do të tentonte të largohej apo shmangej thirrjes së saj, kishte pasoja tepër të rënda. Sanksioni që do të binte mbi këtë subjekt ishte “çkishërimi” dhe “mallkimi” nga ana e Kishës.

Tregtarët e vegjël, zejtarët, bujqit etj., i nënshtroheshin gjykimit të organeve gjyqësore të mitropolisë (gjykatave episkopale apo kishtare) të cilat jepnin vendime bazuar në të drejtën Bizantine dhe të drejtën zakonore të vendit. Me ndryshimet e mëtejshme në të drejtën procedurale, paditësi paraqitej te Mitropoliti dhe kërkonte me shkrim sjelljen para gjykatës të të paditurit. I padituri thirrej para gjykatës me ftesë gjyqësore dhe përballëj me atë që e kishte paditur. N.q.s. nuk paraqitej para gjykatës, i padituri thirrej për herë të dytë dhe të fundit, dhe n.q.s. nuk i bindej urdhërit të gjykatës edhe këtë herë, dënohej me çkishërim.

Duhet theksuar se dënimi me çkishërim dhe mallkim ishte më i rëndi dhe banorët e krishterë të Pashallëkut e quanin këtë akt, fatkeqësinë më të madhe të familjes të të dënuarit me këtë dënim të rëndë, sepse, përveç ndjenjës së turpfit dhe të frikës që i mbulonte nga çkishërimi, kjo lidhej edhe me veçimin dhe përbuzjen e bashkëqytetarëve apo bashkëfshatarëve duke humbur mundësitë dhe lidhjet ekonomike, tregtare, përveç atyre shoqërore dhe humane.

Madje edhe bagëtitë e të dënuarit me çkishërim, nuk lejoheshin të kullosnin në tufën e përbashkët të fshatit, pasi konsideroheshin “të molisura” (të infektuara). Kaq forcë kishte ky sanksion “çkishërimi”, sa që edhe vetë turqit, kur kishin pretendime ligjore ndaj të krishterëve, kërkonin që këta të fundit të gjykoreshin nga institucionet gjyqësore kishtare dhe insistonin që i padituri (i krishterë) të merrte dënimin e tmerrshëm të “çkishërimit” dhe “mallkimit”.¹⁰

E drejta zakonore, ishte një tjetër sistem normash ligjore, që vepronte në disa enklava të veçanta gjeografike të Pashallëkut të Janinës. Të tilla ishin ato territore, të cilat nga pikëpamja e vendndodhjes,

⁹ Dionysios A. Zakythinis, *Krijimi i Greqisë moderne, Nga Bizanti te pavarësia*, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2010, f. 64-70.

¹⁰ Dh. Zotou, *I dhigeosini...*, f.45-46.

shtrirjes, distancës nga metropoli, kushteve të vështira të terrenit dhe mundësive të kufizuara urbane dhe klimatike, administrata qendrore e kishte më të lehtë t'i linte ato politikisht me një gjysëm pavarësie; ligjërisht në vetëadministrim përmes normave zakonore tradicionale të brendshme, sesa të paguante një kosto relativisht të lartë politike, administrative dhe financiare.¹¹

Një enklavë e tillë, që gëzonte prej kohësh këtë status ishte krahina malore e Zagorohórias (Zagoria greke), një trevë me rreth 46 fshatra në juglindje të Janinës. Fshatrat e kësaj zone kishin krijuar një “Federatë” e cila ishte njohur si e tillë që në vitin 1431 duke siguruar një lloj autonomie që konsistonte në mosndërhyrjen e pushtetit osman në administrimin e çështjeve lokale. Studiuesi grek, Zakythinos, kur flet për vetëadministrimin ligjor të kësaj krahine shprehet: “Dokumente të viteve 1828 dhe 1832 dëshmojnë rreth një përpjekjeje për të kodifikuar zakonet si dhe për ekzistencën e një urdhërese, tipike për këtë krahinë për rregullimin e pajës”.¹²

Një grupim tjetër fshatrash që gëzonin një status të veçantë ishin fshatrat vllahe të ndara në dy federata: Federata e parë me qendër Kalaritën dhe tjetra me qendër Sirakan. Çdo fshat kishte zotin e vet. Banorët qenë blegtorë shëtitës – vllhë. Këto fshatra, herë të grupuara dhe herë të shpërndara, qenë dislokuar në zonat malore nga Pindet në Olimp dhe formonin një numër prej gati njëqind fshatrash, duke formuar dy grupime të mëdha apo federata.

Federata e Sirakos kishte 42 fshatra dhe sundohej nga Anthim Gazi, ndërsa Federata e Kalaritas varej nga Kryepleqësia e Zagorisë.¹³

Këto krahina patën një sistem vetëqeverisës mjaft të zhvilluar duke i ruajtur institucionet e vetëqeverisjes të paprekura deri në vitet e fundit të sundimit osman.

Në këto fshatra çështjet gjykoreshin në përputhje me normat e Armenopulos të përkthyer në gjuhën e tyre (vllahe), të cilat konsideroheshin nga ky komunitet si një e drejtë e nacionalitetit vllah (për t'u dalluar nga normat që zbatoheshin në nacionalitetet e tjera).

¹¹ Sp.P. Aravantino, *Historia tou Ali Pasha tou Tepelenli*, Vol. I, Athina: Pirros, 1895, f. 60-66.

¹² D. A. Zakythinos, *Krijimi i Greqisë moderne...*, f.83.

¹³ Konstantinos Paporigopoulo, *Istoria tou elinikou ethnou*, Vol.V, f. 899.

Një tjetër krahinë me status të veçantë politik e ligjor ishte Suli, me rreth shtatë fshatra kryesore (apo dominantë) populluar me shqiptarë¹⁴, e shtrirë në afërsi të brigjeve lindore të detit Jon.

Çdo fshat i Sulit formohej nga një trung, pra nga një farë (bëhet fjalë për 47 fara apo fise të cilat drejtoheshin nga njeriu më i moshuar ose më i respektuar¹⁵) çka nënkupton se të gjithë banorët e fshatit ishin në lidhje familjare e farefisnore mes tyre. Të 47 krerët e fiseve formonin një këshill që vendoste për të gjitha çështjet me karakter publik. Në vend të ligjeve të shkruara, banorët e Sulit rregullonin jetën shoqërore në bazë të zakoneve të lashta (një lloj e drejte zakonore e trashëguar). Këto norma parashikonin zgjidhjen e problemeve të vështira të jetës së përbashkët, të vendosura nga Këshilli i përbërë nga drejtuesit e katër fshatrave kryesore.

*“Në këtë mënyrë urdhëresat e Armenopulos nuk zbatoheshin nga Suli, përveç atyre që kishin epërsi ndaj zakoneve të vendit”*¹⁶

Disa nga normat e të drejtës zakonore që rregullonin marrëdhëniet kryesisht familjare, por edhe të tjera:

- nuk mund të prishej fejesa mes dy të rinjve vetëm me kërkesën dhe vullnetin e njëres palë, por pashmangshmërisht, duhet të bëhej dasma, pasi fejesa konsiderohej një rit i shenjtë. Kjo mund të ndodhte vetëm nëse një prej të fejuarve konsiderohej me vese (kryesisht morale)
- në rast vdekjeje të një prej bashkëshortëve, nuk lejohej t’u ktheheshin të afërmeve të personit të vdekur vlera e sendeve personale, por duhet të ktheheshin ato në çfarëdo gjendjeje që ishin.
- Vajzat që kishin marrë prikë me rastin e martesës nga pasuria prindërore, nëse mbeteshin vejusha, nuk kishin më të drejtë të trashëgonin pjesë nga kjo pasuri pas vdekjes së prindërve. “Ç’morën për prikë e morën njëherë e mirë!”¹⁷

¹⁴ Përkatësia shqiptare e Sulit është konfirmuar nga shumë autorë, mes tyre: Richard Alfred Devanport, *The life of Ali Pasha of Tepeleni, vizier of Epirus*, London, Thomas TEEG and son, 1827, f. 89; S.Llambros, “Neo Ellenomemnon”, në: *Ta ellenika dikaia*, 10, 1913, dhe *Deux etudes sur la Grece moderne*, Paris: 1905, f.113.

¹⁵ R. A.Devanport, *The life of Ali Pasha...*, f. 93-94.

¹⁶ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f.50.

¹⁷ Edhe Kanuni i Labërisë, kur flet për ndarjen e pasurisë mes vëllezërve e motrave, përmban pak a shumë të njëjtën normë: neni 191, pika 2, “vajzave të

- Fëmijët nuk gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar lidhjen e martesës, nëse prindërit vendosin për të.
- Nuk u lejohej klerikëve të jepnin apo merrnin para me fajde.¹⁸

Këto norma të së drejtës zakonore, të cilat respektohen nga popullsia e Pashallëkut të Janinës, i gjejmë edhe në kanunet shqiptare.¹⁹

Sistemi i së drejtës latine (romake), që buronte nga statutet e qyteteve latine, ishte një tjetër legjislacion apo sistem normash, që shtrinte juridiksionin e tij vetëm në ato pjesë terriroresh të Pashallëkut që ishin në zotërim të venecianëve. Këta të fundit kishin shekuj që kishin në zotërim disa qytete dhe terriore krahinash bregdetare në Jon dhe Egje. Disa nga këto qytete ndodheshin brenda kufijve terriorialë të Pashallëkut të Janinës. Në radhën e qyteteve që ishin në zotërim të venecianëve qenë Butrinti, Parga, Preveza, Vonica, ishujt e Santa Maurës, Zaqinthos etj. Për administrimin dhe rregullimin e jetës politike, ekonomike dhe ligjore të këtyre zotërimeve, vepronin normat e Statutit ligjor të Republikës së Venedikut.²⁰

Në këto dominione nuk shtrinin dot efektet e tyre ligjet e Perandorisë Osmane, për rrjedhim as ato të pashallëkut të Janinës. Ishte ky shkak që shpesh këto terrene ktheheshin në strehë të sigurta për kundërshtarët e Pashait, disidentë, komitë të rregjur dhe deri kriminelë ordinerë. Jo një herë gjenden “kërkesa”, “protesta” madje edhe “kërcënime” të Ali Pashës drejtuar guvernatorëve venecianë të këtyre bazave, që ata të dorëzonin apo ekstradonin tek tepelenasi “kriminelët e kërkuar”, që strehoheshin në zotërimet e tyre, për t’u përgjigjur kështu përpara ligjeve të pashallëkut.²¹

* * *

Ali Pasha në tërësi, që nga koha e marrjes së pushtetit, pranoi gjendjen e qyteteve apo krahinave me status të veçantë ligjor, por kjo nuk do të thoshte se në ëndrrat e tij të heshtura ai nuk i synoi ato. Kështu,

martuara u llogaritet paja për pjesë”, shih gjithashtu nenin 23 të këtij kanuni: “gruaja nuk ka të drejtë trashëgimie as te baba, as te burri”.

¹⁸ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f. 47.

¹⁹ *Kanuni i Labërisë*, Kodifikuar nga Prof.Dr. Ismet Elezi, Pjesa IV, “Rendi Shoqëror”, Tiranë: “Toena”, 2006, f.73-135.

²⁰ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f.50-51.

²¹ R.A. Devanport, *The life of Ali Pasha...*, f. 340, 365, 367.

brenda një kohe të shkurtër mbas marrjes së fronit, ai goditi ashpër dhe futi nën pushtetin dhe hegjemoninë e tij absolute Himarën, duke i hequr asaj përfundimisht privilegjet politike dhe statusin e veçantë ligjor.²²

Mbas tre fushatash të ashpra ushtarake, më 1803 përfundimisht nënshtroi Sulin duke e kthyer këtë krahinë, apo “Republikë të pavarur malore” nën administrimin dhe pushtetin ligjor të tij.²³ Kujtojmë se, deri atëherë banorët e Sulit, i paguanin Portës së Lartë taksën e zakonshme të “rajave” dhe “të dhjetën”. Suliotët, i vilnin këto taksa, pra “të dhjetën” dhe “haraçin” nga fshatrat e tjerë të cilat ata i sundonin, pra që kishin nën varësinë e tyre.

Ndërkohë që ishin nënshtetas të Perandorisë Osmane, suliotët kishin nën pushtetin e tyre shtetas të tjerë. Në këtë mënyrë ata ishin edhe sundues edhe të sunduar.

Konfederata Suliote kishte njëfarë ngjashmërie me qeverisjen (regjimin) në Spartën e lashtë, ku disa fshatra kryesore kishin një dominancë mbi fshatrat e një niveli më të ulët. (Shtatë fshatrat kryesore të Sulit kishin 60 fshatra të dorës së dytë nën dominim). Të njëjtat marrëdhënie kishin Spartanët me fqinjët e tyre. Pra, një shtet brenda shtetit.

Po ashtu, Aliu shoi përfundimisht privilegjet e veçanta dhe statusin eksterritorial politik që gëzonin qytetet e Prevezës, Pargës, Vonicës dhe Butrintit, nën zotërimin politik venecian dhe mandej nën atë francez. Ai, duke shfrytëzuar Marrëveshjen e Stambollit të vitit 1800 dhe zhvillimet politiko-ushtarake në Europë, kryesisht humbjen e fushatave të Bonopartit, më 1807-1808, i goditi ushtarakisht dhe i vuri këto qytete një herë e përgjithmonë, më 1809 nën autoritetin e plotë të shtetit të tij.²⁴

* * *

Sidoqoftë, duhet nënvizuar se sistemi i së drejtës i cili dominonte dhe administronte në tërësi veprimtarinë ligjore të Pashallëkut të Janinës, si pjesë integrale e Perandorisë Osmane, ishte Sheriati – Statut ligjor themelor i cili trajtonte dhe shqyrtonte të gjitha çështjet dhe problemet

²² *Historia e popullit shqiptar...*, vëll.I, f.642-649; Shih gjithashtu: L.Ars Grigoris, *I Rosia qe ta pasalikia Alvanias qe Ipirou, 1759-1831*, Athina: 2007, f.61.

²³ *Arxeio Ali Pasha...*, Vol.I, f.351-353, 362-374.

²⁴ G. Vaudoncourt, *Memories of the Ionian...*, f. 292-297.

ligjore e juridike të jetës qytetare e shtetërore, private e kolektive. Në të përfshiheshin sa çështjet penale, aq edhe ato civile, sa ato administrative, aq edhe ato familjare, sa ato proceduriale, aq edhe ato urbane e fiskale.

Por, ky nuk ishte ndonjë deformacion i veçantë që vërehej vetëm në Perandorinë Osmane. Sistemet e së drejtës në Europën e shekullit të XVIII administronin veprimtarinë e tyre ligjore po ashtu me statute unike. Porta e Lartë, në kuadër të reformave të Tanzimatit, nisi vetëm në vitin 1840 punën për njësimin e të drejtës me miratimin e Kodit Penal (Ceza Kanunamesi).²⁵ Duhej të vinte revolucioni francez dhe reformat e mëdha legjislative të Bonopartit, të fillimit të shekullit të XIX, të cilat do të bënin për herë të parë ndarjet dhe kodifikimet ligjore.

* * *

Organet e Drejtësisë - Strukturat - Llojet e krimeve - Llojet e dënimeve

Nëse pak më lart përmendëm gjithë sistemet ligjore të cilat vepronin dhe shtrinin efektet e tyre në zona dhe pjesë të caktuara të popullsisë të Pashallëkut të Janinës, padyshim që tërësia e këtyre normave materializohet përmes institucioneve dhe strukturave konkrete të drejtësisë.

Duhet thënë që në fillim, se edhe në territoret e pashallëkut, që nga koha e pushtimit dhe konsolidimit të fuqisë dhe pushtetit osman, ishin ngritur dhe funksionin gjykatat të atij tipi dhe atyre modeleve, që aplikoi Perandoria me kodin bazë të Sheriatit. Por, me rritjen dhe fuqizimin e pushtetit dhe autoritetit politik të Ali Pashës, këto institucione patën një prirje dhe u konfiguruan drejt pavarësisë dhe decentralizimit apo shkëputjes nga sistemi qendror i drejtësisë osmane.

Duke iu referuar konkretisht strukturave dhe institucioneve që realizonin drejtësinë, duhet nënvizuar se padyshim, sistemi i drejtësisë në pjesën më të madhe, në territoret e Pashallëkut të Janinës, ushtrohej prej Gjykatave të shtetit, të cilat ishin të organizuara (strukturuara) në dy shkallë, në:

- Gjykata të Shkallës së Parë dhe,
- Gjykata të Shkallës së Dytë

²⁵ Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: "Dituria", 2004, f.442-444.

Veç tyre, funksiononte herë pas here (jo për të gjitha çështjet), edhe Këshilli i Drejtësisë që drejtohej nga vetë Ali Pasha dhe që shërbente si shkallë e epërme e gjykimit.

- **Gjykatat e Shkallës së Parë** përbëheshin nga tre gjyqtarë dhe dy plotësues. Këto gjykata, me këtë përbërje, gjykonin çështje të drejtës
 - penale,
 - civile dhe,
 - administrative.

Gjykatat e Shkallës së Parë, të cilat hetonin dhe gjykonin krimet përbëheshin nga tre gjyqtarë dhe një sekretar, i cili kryente edhe funksionin e hetuesit.

Vlen për t'u theksuar që funksioni i avokatit as që mund të mendohej të ushtrohej në Pashallëkun e Janinës, si në gjykimet civile ashtu edhe në ato penale.

Gjyqtarët dhe nëpunësit e tjerë

Nëpunësit e insitucioneve të drejtësisë, që vinin në lëvizje dhe shqyrtonin të gjitha rastet e parashikuara nga ligji ishin disa. Sipas të drejtës otomane, gjykatësit që gjykonin çështje të ndryshme dhe kishin nën juridiksionin e tyre popullsinë myslimane ishin:

- **Kadiu** (gjyqtari i vetëm) caktohej nga qeveria qendrore dhe gjykonte përgjithësisht të gjitha çështjet civile e penale që nuk shqyrtoheshin nga organe të tjera dhe për të cilat nuk ishte përcaktuar ndonjë juridiksion i veçantë.²⁶ Përveç punës së rregullt gjyqësore, kadilerët kryenin edhe shumë detyra të tjera administrative.

- **Mullai**

- Funksionet e Kadiut (dhe të Mullait) shkonin sa nga kompetencat fetare aq edhe nga ato gjyqësore.
- **Kadilerët** kategorizoheshin në pesë rangje:
- Rangu i parë përbëhej nga “6 mullahët e mëdhenj”. Rangu i dytë ishin “mullahët e vegjël”, të cilët shërbenin si gjykatës në qytete të kategorisë së dytë për nga rëndësia dhe numri i popullsisë. Rangu i tretë përfshinte “mufetët”, të cilët

²⁶ *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, Grup autorësh, Tiranë: Shtëpia Botuese “Luarasi”, Botimi i tretë, 2005, f. 227.

merreshin kryesisht me mbledhjen e taksave dhe zgjidhjen e konflikteve të natyrës financiare. Në rangun e katërt shërbenin “kadilerët apo gjykatësit kryesorë”, të cilët në vilajetin e Rumelisë, që u bë më pas baza e shtetit të Ali Pashës, numëroheshin në 197. Në kategorinë e pestë renditeshin “naibët”, të cilët mund të konsideroheshin si ndihmës apo gjyqtarë plotësues të kadilerëve dhe mullahëve²⁷. Gjithsesi, të gjithë kategoritë e mësipërme, së bashku me myftitë, kishin të drejta për të gjykuar si çështje penale edhe ato civile, dhe njëkohësisht, shërbenin edhe si noterë, për të kryer veprime të ndryshme mes qytetarëve apo për të vërtetuar fakte.²⁸

- **Myftijtë.** Qytetet e mëdha kishin një myfti më vete, ndërsa në qytetet e vogla myftiu dhe kadiu ishin i njëjti person. Kreu i myftijve quhej “Shehulislam” i cili ishte kreu i shtresës së ekspertëve të ligjit islamik në gjithë Perandorinë.

Organe të tjera që kishin funksione kryesisht politike dhe ushtarake, por edhe administrative ishin:

- **Vojvoda** si nëpunës që punonte për ruajtjen e rendit dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore²⁹ dhe,

- **Pashai** si drejtues ushtarak,

Vojvoda dhe pashai, përveç funksioneve të mësipërme në kuadër të organizimit shtetëror, kishin njëkohësisht edhe funksionet e gjykatësve të shkallës së dytë të gjykimit.

Përveç dy shkallëve të gjykimit, siç u përmend edhe më parë, Ali Pasha, duke drejtuar Pashallëkun, gëzonte edhe të drejtën e Kreut të Drejtësisë, që mund të konsiderohet si **Shkalla e tretë e gjykimit**. Në këtë shkallë Ali Pasha mund të gjykonte vetëm ose me mbështetjen e disa njerëzve të tij të besuar që njëkohësisht kishin edhe funksione ministrore si p.sh Zonja Vasiliqi, gruaja e Aliut, Mantho Ikonomi, Sekretar për Drejtësinë (ministër), Aleks Nuço, Spiro Kolovos.

Ky këshill, përveç dhënies së vendimeve pas ankimit të qytetarëve për vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, kishte të drejtë edhe të

²⁷ *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*, Botues: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Osman, Tiranë: 2009, f. 438.

²⁸ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f. 42.

²⁹ D.A. Zakythinis, *Krijimi i Greqisë moderne...*, f.27.

anullonte vendimet me vdekje, të lironte të burgosurit e dënuar apo dhe ata që mbaheshin në pritje të dënimit.³⁰

Ajo që është e rëndësishme të theksohet, është fakti që vendimet e gjykatave nuk ankimoheshin dhe nuk gjykoheshin nga Porta, siç ndodhte në pjesë të tjera të Perandorisë, por nga Ali Pasha. Ky ishte një tregues tjetër i autonomisë së Pashallëkut të Janinës nga Stambolli.³¹

Nëse do të flisnim për drejtësinë e dhënë nga gjykatësit, pra për cilësinë e drejtësisë, është fakt i njohur që gjykatësit në Perandorinë Otomane ishin të korruptuar, kishin institucionalizuar rryshfetin dhe vendimet anonin andej nga jepej edhe oferta më e mirë. Për ta perifrazuar këtë fakt, mund të thuhet që gjykimi kthehej në një ankand, ku fitonte ai, që paguante më shumë.

Kjo ka qënë një plagë e vjetër dhe e përhershme e Perandorisë Osmane, aq sa në periudhat e krizave të rënda të saj, (në shekullin XVI), nën sundimin e dinastisë së Qyprilinjve, këta të fundit u detyruan të ekzekutojnë disa mijëra gjykatës dhe nëpunës të tillë të korruptuar administratës, për të rikthyer autoritetin e Perandorisë dhe besimin tek institucionet.³²

* * *

Llojet e veprave që shqyrtonin Gjykatat Penale

Llojet kryesore të çështjeve penale që shqyrtonin këto gjykata, ishin të gjitha figurat e krimit që parashikonte Sheriati, të tilla si vjedhja, grabitja, vrasja, prostitucioni, dëmtimi i pronës, fallsifikimi, mashtrimi, e deri tek liria e mendimit dhe konspiracioni kundër shtetit. Të gjitha këto dispozita shoqëroheshin nga sanksione, pra dënime tepër të ashpra për të cilat do të flitet më poshtë.

Fakte që gjykimet e konflikteve bazoheshin te Sheriati, gjejmë në Arkivin e Ali Pashës, mbledhur dhe botuar në vitin 2009 në Athinë, nga Instituti i Studimeve Neohelenike. Në këtë Arkiv publikohen për herë të parë dokumenta që hedhin dritë mbi mënyrën e organizimit të institucioneve brenda Pashallëkut, letra të popullit drejtuar Ali Pashës, kërkesa për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga vetë ai etj. Në njërin

³⁰ Dh.Zotou, *I dhigeosini...*, f. 65.

³¹ *Historia e popullit shqiptar...*, Vëll.I, f. 639.

³² R. Mantran, *Historia e Perandorisë...*, f.233-234.

nga këto letra, fshatarë çamë i drejtohen Ali Pashës për të gjykuar e zgjidhur një konflikt që ka lindur lidhur me shpërndarjen e ujit në një zonë bujqësore:

*“ I madhërishmi dhe i shumëndritshmi vezir Ali Pasha
Ne, të bindurit e tu, e bëjmë me dije madhërinë tuaj për punën e skllavit
tuaj Jaçe Rizani, i cili, prej kaq kohësh, megjithëse e ngarkonin
(akuzonin) shokët e tij, ai nuk pranonte të gjykohej as me Sheriat, as nga
‘jerondot’ (pleqësia) e vendit tonë...”*

Më tej letra përshkruan me detaje konfliktin e lindur mes Jaçe Rizanit dhe fshatarëve të tjerë lidhur me bllokimin e vijës së ujit që përdorej për ujitje dhe në përfundim një përfaqësi e fshatarëve i kërkon Ali Pashës gjykimin e të akuzuarit:

*“ .. pra ne kërkojmë që kjo çështje të gjykohet me Sheriatin dhe nën
urtësinë tuaj, të ndahen gjërat në bazë të së drejtës dhe jo siç do njëri
apo tjetri. Dëgjona të dy palët dhe jepi ndëshkimin që i takon secilit...”³³*

Në fund të letrës jepen emrat dhe nënshkrimet e kërkuesve.

Dënimet kryesore të parashikuara nga ligji penal, që aplikoheshin për krime të ndryshme, ishin nga ato që sot i quajmë të zakonshme: dënimi me burg, me gjobë, zhdëmtim i dëmit të shkaktuar, konfiskim pasurie, rrahje me shkop në sheshet publike, përzënie nga vendbanimi etj., dhe deri dënime që sot mund të konsiderohen të llahtarshme, por që aso kohe ishin të parashikuara në ligjin e kohës, të tilla si: prerje e gjymtyrëve, vrasje me gurë deri në vdekjen e të dënuarit, mbytje në ujë, shqyerje nga kafshët e egra pasi i dënuari flakej në kafazin e tyre, - djegie në turrën e druve etj.³⁴

Në fakt, këto forma të ekzekutimit të të dënuarve me vdekje nuk ishin origjinale, ato bazoheshin kryesisht te sheriatin (*mbytjen në ujë apo duke qëlluar me gurë deri në vdekje femrat, që akuzoheshin për tradhëti bashkëshortore apo prostitucion, e gjejmë të aplikohet edhe në ditët tona në vendet ku ky ligj penal është ende Sherihati*), por edhe në burime më të hershme të të drejtës si e drejta bizantine apo më herët ajo romake.

Nga dokumentacioni i asaj kohe dhe vendimet e gjykatave për raste dhe dënime ekstreme mund të përmendim dënimet në vitin 1811 të

³³ *Arxheo Ali Pasha*, Instituto Neolinikon Spudhon, Vol.II, Athinë: 2009, f.72.

³⁴ Irakli Koçollari, *Policia sekrete e Ali Pashës*, vëll.I, Tiranë: “Ilar”, 2004, f. 411- 412;

krerëve bejlerë të Kardhiqit si Dostët, Kokat, etj., për krimin e konspiracionit me të huajt, francezët, në dëm të interesave të shtetit; dënimi dhe ekzekutimi, duke i thyer gjymtyrët, i kryengritësit Papa Thimjo Bllahava për konspiracion me rusët; dënimi me vdekje dhe ekzekutimi duke u shqyer nga luani i hajdutit të njohur Gjeka; dënimi dhe ekzekutimi me varje i autorit të poemës “Qikllopi”, J. Karasterjiu, i cili stigmatizonte përmes satirës antihumanizmin e Pashait; ekzekutimi me mbytyje në ujërat e Liqenit të Janinës të 17 femrave janiniote, të akuzuara për ushtrim prostitucioni etj.³⁵

Lidhur me ashpërsinë e Ali Pashës dhe dënimeve të tij është shkruar jo pak. Në studime të ndryshme, herë-herë dënimet e tij janë parë në vetvete si dënime të rënda dhe të llahtarshme, e herë janë vlerësuar si produkt i kohës dhe i të drejtës që sundonte në Perandorinë Osmane. Nuk duhet lënë pas dore në këtë analizë edhe fakti që, kur erdhi në pushtet Ali Pasha, në territoret ku ai sundoi, mbizotëronte krimi, anarkia, mungesa e rendit dhe qetësisë, vendi ishte në duar të kleftëve (hajdutëve).

Në një dialog mes Ali Pashës dhe çifutit Ibrahim Manzur Efendi, vetë Aliu shprehet:

“Nuk i njeh akoma ti grekët dhe shqiptarët. Nëse var njërin prej tyre në degë të lisit, vëllai i të varurit në të njëjtën kohë vjedh poshtë të njëjtës pemë. E nëse do të urdhëroja të digjej ndonjëri në zjarr, vetë fëmija e tij s’do ta kishte për gjë të mblidhte hirin e të atit dhe ta shiste. Kështu që vetëm me frikë mund t’i qeverisësh këta njerëz”.³⁶

* * *

Sistemi i normave juridike dhe institucionet në fushën e tatim-taksave

Lidhur me normat që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e tatimeve dhe taksave (e drejta fiskale) në Pashallëkun e Janinës, është studiuesi grek I. Lambridhi, i cili në veprën e tij “Ali Pashë tepelenasi” (O Ali Pasas o tepelenlis) flet së pari për tatimin mbi shitjen e pasurisë, sipas të cilit: “*asnjë shitje e pasurisë nuk është e lejuar, nëse më parë nuk është paguar një e dhjeta e vlerës së pasurisë*”³⁷

³⁵ Sp.P. Aravantino, *Historia tou Ali Pasha...*, f. 378-383.

³⁶ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f. 125.

³⁷ I. Lambridhi, *O Ali Pasas o tepelenlis*, f. 37.

Lambridhi gjithashtu na sjell edhe rregullimet lidhur me të drejtën e trashëgimisë:

“në rast vdekjeje, kur nuk rezulton të ketë trashëgimtarë, trashëgon Aliu, d.m.th. shteti.”³⁸ Kur murtaja shfarosi banorët e Artës, shteti trashëgoi pasuritë e gjithë atyre që nuk lanë trashëgimtarë. Por kjo trashëgimi nuk u keqpërdor, pasi ajo u përdor në dobi të banorëve të Lamarit për t’u vendosur në pronat e fatkeqëve të Artës.”³⁹

Ndërkohë mund të thuhet që Ali Pasha përdori një sistem të ndërlikuar dhe të rënduar taksash, sistem i cili anulonte pjesërisht pasojat pozitive të politikave të tij ekonomike. Barra fiskale që rëndonte mbi popullsinë e Pashallëkut në kohën e Aliut, vlerësohej disa herë më e madhe në raport me periudhat para tij (duke llogaritur sigurisht edhe inflacionin).⁴⁰ Por siç është theksuar edhe më sipër, Aliu erdhi në pushtet në një periudhë ku sundonte anarkia, antiligji, kusaria, mospagimi i taksave etj. Prandaj masat e tij, nga ato ligjore, deri në ato represive për vendosjen e rendit, respektimin e institucioneve, sigurisht prekën edhe xhepat e qytetarëve të thjeshtë apo tregtarëve që ishin mësuar me shmangien nga detyrimet fiskale.

E drejta për mbledhjen e taksave u jepej me koncesion disa bejlerëve dhe individëve të tjerë, të cilët duhej, jo vetëm të mbidhnin taksat që pretendonte Aliu si e drejtë e tij, por edhe të gjenin në njëfarë mënyre shumat e nevojshme për pagesën e haraçit vjetor për sulltanin në Stamboll. Kur ndonjëri prej tyre nuk arrinte të mbledhte shumën e përcaktuar, Aliu e fuste në burg, derisa ai apo familja e tij të paguanin shumën e mbetur si shpërblim për lirimin e tij. Në këtë mënyrë ai krijoi namin si njeri i pamëshirshëm me taksambledhësit e paaftë, saqë të ardhurat e mbledhura prej tyre ishin shpesh më të larta se shumata e kërkuar në fillim.⁴¹

Burimet e të ardhurave të tij ishin timaret, kopetë e shumta dhe tatimet që i grumbullonte me më pak mund se në pjesët e tjera të Perandorisë Osmane.⁴²

³⁸ *Po aty.*

³⁹ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f.68.

⁴⁰ Katherine E. Fleming, *Bonaparti mysliman, Diplomacia dhe orientalizmi në Greqinë e Ali Pashës*, Tiranë: Shtëpia botuese “Dituria”, f.74.

⁴¹ *Po aty*, f. 73-74.

⁴² Alphonse de Beauchamp, *Ali Pashë Tepelena*, Pejë: “Dukagjini”, 2003, f.103.

Lidhur me llojet e taksave dhe tatimeve që aplikoheshin në Pashallëkun e Janinës nga 1788-1820, kemi si më poshtë:⁴³

1. taksa e doganës
2. tatimi personal (haraçi)
3. e dhjeta
4. taksa e bagëtive (e dhenve)
5. taksa e verës
6. taksa mbi fëmijët e mitur meshkuj
7. taksë për sunduesin e Rumelisë
8. taksë për kreun e Janinës
9. bakshish për tagrambledhësin
10. taksa për ushqimin dhe pagesën e 200 armatollëve
11. taksa për shërbimin postar dhe qiranë e godinave të postës
12. shpërblim për bimbashët, për ushqimin dhe banesat e tyre të përkohshme
13. si më sipër, shpërlimi (paga) që i dërgohej sunduesit të Rumelisë
14. shpërblimi i mëkëmbësit të sunduesit të Rumelisë⁴⁴

Në vitin e fundit të sundimit të tij, Ali Pasha aplikoi falje (ajo që ne quajmë amnisti fiskale sot) lidhur me taksat që duhet të paguheshin, në masën 2.250 groshë.

Pas vdekjes së Aliut dhe nën sundimin e Hurshid Pashës, deri në vitin 1830, shtohen edhe 13 taksa të tjera, deri sa më 1831, kur u regjistruan familjet e të gjitha zonave të pashallëkut, u bë unifikimi (njësimi) i taksave, përveç taksës së verës e cila afirmohet si një taksë e përgjithshme. Të gjitha llojet e taksave të përmendura më sipër, vilesin në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç taksës së doganës e cila vilej në mënyrë të tërthortë.

Në përshkrimet e të gjithë atyre që kanë njohur nga afër Ali Pashën dhe shtetin e tij, që nga Pouqueville-i te Leak-u, nga Henri Holland te Hughes, si dhe nga historianë grekë e të tjerë, dëshmohet që taksat e aplikuara ishin shumë të rënda dhe të papërballueshme, pra dëshmohet një aspekt tjetër i ashpërsisë së Ali Pashës ndaj shtetasve të vet.

⁴³ Dh. Zotou, *I dhiqeosini ...*, f. 68-69.

⁴⁴ Shih gjithashtu *Arhio Ali Pasha*, Vol.I-II-III, Genadhio Bibliothikis, Athina: 2009.

Histori dhe rrëfenja të shumta lidhur me ngjarje që linin gjurmë ndër qytetarët e Janinës dhe të zonave përreth, tregohen pa fund dhe vijnë sot nga bashkëkohës, historianë, udhëtarë dhe të mikpritur në oborrin e Aliut, shërbëtorë dhe armiq të tij, grekë, anglezë, francezë, rusë, venecianë etj.

Ndërkohë që të gjithë kanë vërejtur jo pa habi në shumë raste, rendin dhe sigurinë që i ka shoqëruar në udhëtimet e tyre në këtë skaj të Perandorisë Osmane, por edhe zhvillimin e madh që kjo zonë mori nën sundimin e Ali Pashës. Është rasti për t'u theksuar se përfundime nga më të ndryshmet shoqërojnë studime, vëzhgime apo dhe kujtime të bashkëkohësve lidhur me pasurinë personale të Aliut dhe mënyrën e vendosjes së saj. Ka mendime që një pjesë e mirë e të ardhurave që vilesnin nga taksat publike, shkonin në xhepin e Aliut, gjithashtu në studime të ndryshme numërohen vepra të shumta publike të ndërtuara me këto të ardhura. Këto punë publike konsistojnë në:

- ndërtime rrugësh, bujtinash apo hanesh, duke lehtësuar udhëtarët dhe tregtarët e shumtë që qarkullonin nga një anë e Perandorisë në tjetrën. Sipas Katherinë E. Fleming në veprën e saj “Bonaparti mysliman. Diplomacia dhe orientalizmi në Greqinë e Ali Pashës”, duke iu referuar Leak, thuhet se nga Trikala në Janinë, kishte hane për çdo një orë rrugë.
- Vepra bonifikuese si tharja e kënetës dhe moçaleve në veri të Artës nën drejtimin e inxhinierëve evropianë, duke e shndërruar atë në një nga fushat më pjellore në vend.
- Ngritja e urave dhe vendosja e trageteve në lumin Drinos
- Ndërtimi i objekteve me karakter rezidencial, fortifikues ushtarak si kalaja e Tepelenës, kalaja e Palermos etj.
- Nxitja e ndërtimit të objekteve me karakter kulturor si Gjumnazi “Zosimea” etj. Është e njohur shprehja që përdorej në atë kohë për Janinën: “Janina e para në armë, në groshë dhe në kulturë”⁴⁵

* * *

Ali Pasha si gjykatës

Shteti i Aliut duhet parë si pjesë e Perandorisë Osmane, pra si një shtet autokratik dhe nuk duhet bërë krahasimi me shtetet e tjera europiane nga pikëpamja e organizimit të brendshëm shtetëror. Teoria e ndarjes së

⁴⁵ K. E. Fleming, *Bonaparti mysliman...*, f. 70.

pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe e ushtrimit të tyre në mënyrë të pavarur, hartuar nga Monteskie, dukej shumë e largët për t'u realizuar në një shtet që funksiononte sipas parimit: nuk ka pushtete të ndryshme në një shtet. Pushteti është një dhe i vetëm, ai ushtrohet në emër të sunduesit të vetëm Ali Pasha. Ai ishte kreu i të gjithë pushteteve: “Unë, Vezir Ali Pasha urdhëroj”, kështu fillonin aktet e nënshkruara prej tij. Ministrat apo sekretarët e ushtronin pushtetin në emër të tij, ndërsa lidhur me pushtetin gjyqësor ai konsiderohej Kreu i plotfuqishëm i tij.

Më poshtë është sjellë një pasazh nga kujtimet e mjekut Henri Holland në një nga vizitat e tij në Janinë në shërbim të Pashait.

“Një apo dy herë qëllova të jem i pranishëm, kur Ali Pasha dëgjonte ankues të ndryshëm, që fati i kishte ndihmuar të vinin para tij. Ky ishte një spektakël tejet interesant. Çdo ankues, ndërsa afrohej, përgjunjej, puthte petkun e tij, pastaj tregonte çështjen e kërkesës apo ankesës së tij. Reagimi i Ali Pashës në këto raste ishte i shpejtë dhe i vendosur. Kuptohej, që aty për aty formulonte një gjykim dhe nuk tërhiqej nga e tija. Ai vetë fliste dendur dhe shpejt, por dukshëm me një vëmendje të madhe kundrejt çështjes, me dëshirën për të vendosur drejtësi. Kjo shpejtësi zgjidhjeje është pa dyshim e nevojshme, duke patur parasysh mizërinë e çështjeve që paraqiteshin. Ai mund të konsiderohet pothuajse si gjyqtari i vetëm i zotërimeve të veta dhe, megjithëse mungesa e ligjeve të shkruara dhe precedentëve i thjeshtësonte të gjitha rastet në shqyrtimin e thjeshtë të barazisë, nuk duhet të habitemi se si vonohet çështja, kur i është besuar plotësisht punës dhe gjykimit të një njeriu. Gatishmëria për t'u marrë personalisht me të gjitha çështjet, është një cilësi mbresëlënëse e karakterit të Ali Pashës dhe influencon në të gjitha punët e qeverisjes së tij. Prej kësaj rrjedh ai unitet i sistemit që shtrihet në tërë zotërimet e tij, që e bën personalisht atë objekt të një droje pothuajse të mistershme të shtetasit e tij, po aq sa bën fuqinë e tij të frikshme për fqinjët apo integritetin e Perandorisë Turke.

*Duhet të shënoj se askush nga ata që ndodhen rrotull tij, i njej po aq mirë sa Aliu të gjitha krahinat e zotërimeve të tij, zakonet, madje edhe personat, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me zbatimin e drejtësisë”.*⁴⁶

⁴⁶ Henri Holland, *Mjek te Ali Pasha*, Tiranë: Shtëpia botuese “Migjeni”, 2008. f 113-115.

Modele të bujurdive (urdhërave apo vendimeve) të Ali Pashës

Bujurditë mund të konsiderohen si akte normative në formën e vendimeve dhe urdhëresave të cilat nisur nga subjektet të cilëve u drejtohen kanë karakter të përgjithshëm, kur u drejtohen të gjithë banorëve të pashallëkut, ose karakter individual, kur i drejtohen një individit ose një grupi të vogël individësh.⁴⁷

Vendimet dhe urdhrat (bujurditë) e Ali Pashës ishin të shkurtra, të prera, në fund të fundit ato ishin imperative dhe të padiskutueshme apo ankimueshme. Ato nga pikëpamja e formës ishin të ndërtuara pothuajse njësoj: pas formulës së njohur “Unë vezir Ali Pasha urdhëroj!”, vazhdonin me subjektin të cilit i drejtoheshin, me përmbajtjen e urdhrat, me datën dhe vendin e marrjes së vendimit (zakonisht Janina, por jo vetëm) si dhe në fund firmoseshin e vuloseshin prej tij. Këto vendime nuk lidheshin vetëm me gjykimin përfundimtar të çështjeve të ndryshme penale apo civile. Mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e punëve në shtetin e tij, Ali Pasha konsideronte edhe konfliktet e ndryshme administrative që lidheshin me marrëdhëniet mes njërive të ndryshme administrative, pjesë e Pashallëkut.

Më poshtë sillen një shembull konkret i një vendimi të Ali Pashës lidhur me ndarjen e kufijve mes disa fshatrave, për të shmangur konfliktin në përdorimin e tokave:

“Unë, vezir Ali Pasha urdhëroj:

Lekliotët dhe hormovitët⁴⁸ të vendosin kufijtë mes tyre dhe nga sot e tutje kufiri mes dy fshatrave do të jetë nga lumi deri te përroi i thatë dhe nga maja e malit e deri në tri hedhje guri, të dy fshatrat do të kenë kufi me Malëshovën⁴⁹. Secili nga fshatrat, Lekli dhe Hormova, të respektojnë kufijtë që u vendos unë shtetasve të mi dhe të dy fshatrat të jetojnë në harmoni me njëri -tjetrin. Nuk lejoj që t'i krijojnë probleme njëri-tjetrit pas këtij vendimi.

*Janinë, 11 qershor 1803
(firma, vula)”⁵⁰*

⁴⁷ Arta Mandro-Balili, *Pashallëqet feudale shqiptare nën këndvështrimin e shtetit dhe të drejtës; Rasti i Pashallëkut të Shkodrës dhe Pashallëkut të Janinës*, Tiranë: “Mediaprint”, 2008, f.188.

⁴⁸ Përkatësisht banorë të fshatrave Lekël dhe Hormovë (sot bëjnë pjesë në rethin e Tepelenës. Të dy fshatrat i përkasin krahinës së Rrëzës (shënimi im - I.Nano).

⁴⁹ Fshat në Përmet.

⁵⁰ Dh. Zotou, *I dhiqeosini...*, f. 115.

PËRFUNDIME

Në Pashallëkun e Janinës vepruan paralelisht mbi pjesë të ndryshme të popullsisë, sisteme të ndryshme ligjore.

Sheriati ishte sistemi bazë i normave juridike që vepronte në Pashallëkun e Janinës, sikundër në gjithë territoret e Perandorisë Osmane. Ky sistem normash së bashku me institucionet përkatëse të ngritura në funksion të tij u adoptua dhe u zbatua nga Ali Pasha në shtetin e tij si një sistem normash dhe institucionesh, relativisht të pavarura nga Porta e Lartë.

E drejta zakonore ishte gjithashtu një sistem normash më i vjetër se Sheriati dhe që kishte zënë rrënjë të forta në popullsinë e Pashallëkut të Janinës, fenomen ky jo origjinal dhe që ka ekzistuar historikisht dhe jo vetëm në këto territore. E veçanta qëndron pikërisht në shumëllojshmërinë e normave të të drejtës zakonore, nisur nga heterogjeniteti kombëtar. Në Pashallëkun e Janinës bashkëjetonin popullsi me kombësi të ndryshme: shqiptarë, grekë, vllahë, turq, madje edhe një numër i konsiderueshëm hebrejsh, të cilët në komunitetet e tyre zbatonin secili zakonet e veta, kryesisht ato që lidheshin me të drejtën familjare.

E drejta bizantine (kishtare) përbëhej nga tërësia e normave që kishin mbetur dhe zbatoheshin ende, edhe pas rënies së Perandorisë Bizantine. Këto norma zbatoheshin kryesisht nga popullsia e krishterë e Pashallëkut dhe institucionet që aplikonin këtë të drejtë, ishin ato kishtare. Këto norma njiheshin si Heksabiblos (gjashtë librat) apo Armenopulos sipas emrit të juristit që i mblodhi ato.

E drejta latine është termi më i përshtatshëm për të karakterizuar normat juridike që vepronin në pjesë të ndryshme të Pashallëkut të Janinës dhe që ishin në zotërimin e Republikës së Venedikut. Më pas këto province kaluan nën zotërimin francez dhe së fundi, më 1809, ato u vunë përfundimisht nën autoritetin e shtetit të Ali Pashës dhe të institucioneve të tij të së drejtës.

Pashallëku i Janinës, nga pikëpamja e organizimit, kishte karakteristikat e një shteti autoritar dhe e drejta (shtetërore) që zbatoheshin në të ishte pasqyrë e tij. Kemi parasysh këtu si normat, ashtu edhe institucionet që zbatonin këto norma.

I krahasuar shpesh me Bonapartin, i mbiquajturi “luan i Epirit”, Ali Pasha arriti të krijojë një formacion shtetëror të fuqishëm në Perëndim të Perandorisë Osmane, sikundër Bonaparti në Perëndim të Evropës, duke u konsideruar një nga njerëzit më madhështorë të epokës së tij. Sytë e perëndimit u kthyen me një vëmendje të panjohur më parë drejt këtyre territoreve, duke i shndërruar ato në një qendër të rëndësishme ku diplomacia evropiane vepronte me interes të madh dhe intensitet. Shumë janë thënë për Ali Pashën, shtetin e tij, mënyrën e marrjes dhe ushtrimin të pushtetit, egërsinë apo mirësinë dhe sigurisht shumë të pathëna ruhen ende në arkiva, në gojëdhëna apo janë zhdukur në harresën e kohës.

S u m m a r y

SOME FEATURES OF THE SYSTEM OF JUSTICE IN THE PASHALIK OF JANINA

In Ali Pasha's state there were enforced simultaneously different law systems valid for different groups of people living in it.

Shariah was the basic system of legal norms that was used in the Pashalik of Janina, as well as throughout the Ottoman Empire's territories. This system of legal norms together with the respective institutions created to support and implement it, was adopted as a whole in Ali Pasha's state with a relative independence from the Porte.

Customary law was another system of legal norms, older than the *Sheriah* and rooted deeper in the population of the Pashalik of Janina, but this was a phenomenon which had historically existed and moreover was not typical to just these lands. However, to be noted is the multiplicity of the norms included in the customary law, considering the heterogeneous ethnic composition of this state.

The byzantine law (church law) was composed of the number of legal norms that had remained and were still used since the fall of the Byzantine Empire. These legal norms were respected especially by the Christian population of the Pashalik and the institution that enforced them officially was the church. These norms were known as Heksabiblos (*the six books*) or named after the layer who collected them, Armenopulos.

The Latin law is the most appropriate term to describe the legal norms that were enforced in different parts of the Pashalik of Janina which were owned by the Republic of Venice. The state of Ali Pasha was an authoritarian state and

this fact was reflected in the (state) law and the way it was enforced by its institutions.

There has been said a lot about Ali Pasha, his State, the way he gained power and how he exercised his authority, his cruelty or benevolence and certainly there are still more untold stories that are preserved in archives, in legends or that have altogether disappeared with time.

